



*E premte, 11 nëntor 2016*

## NJOFTIM

### Mbledhja e XI e Bordit të ZRRE

**Intensifikohet përkushtimi drejt hapjes së tregut dhe rritjes së numrit të autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëriteshme të energjisë elektrike**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e tij të XI, të mbajtur sot me 11 nëntor 2016, ka vendosur për lëshimin e 5 autorizimeve preliminare për ndërtimin e kapaciteteve të reja prej **12 MW** energji elektrike nga burimet e ripërtëriteshme. Deri më tani ZRRE ka lëshuar autorizime preliminare për ndërtim të njësive të reja gjeneruese në kapacitet prej **85.38 MW**. Në proces të ndërtimit janë po ashtu disa njësi të tjera, për të cilat janë lëshuar autorizimet finale dhe që përbëjnë një kapacitet prej **83.21 MW**, ndërsa tashmë në operim (prodhim) janë **31.15 MW** energji elektrike nga burimet e ripërtëriteshme.

Gjithashtu në mbledhjen e sotme Bordi i ZRRE ka marrë vendim që të aprovojë kërkesën, e ndërmarrjes “GSA ENERGJI” SH.P.K, për Licencë për furnizim me energji elektrike. “GSA Energy” është kompania e tretë, pas Operatorit të Furnizimit KESCO dhe kompanisë “HEP – KS” SH.P.K, që po hyn në tregun e energjisë së Kosovës për të ofruar shërbimet e furnizimit me energji elektrike.

Licencimi i kompanive të reja për furnizim me energji elektrike konsiderohet një hap i rëndësishëm drejt hapjes së tregut të lirë të këtij sektori. Bordi i ZRRE me këtë rast ka dëshmuar se është i përkushtuar në krijimin e kushteve sa më të mira për operatorët e ri që dëshirojnë të futen në tregun e Kosovës për të ofruar shërbime cilësore të furnizimit me energji. Synim i vazhdueshëm i Bordit të ZRRE mbetet ndërtimi i një tregu të qëndrueshëm energjetik ku mbizotëron konkurrenca e lirë dhe konsumatorëve ju ofrohen shërbime të kënaqshme me kosto të arsyeshme.

Bordi po ashtu në këtë takim ka shqyrtuar edhe disa ankesa të konsumatorëve si dhe çështje të tjera Rregullative të sektorit dhe organizimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.